



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr.04/ 5236/2026

DATA:	10.06.2026
PËR:	Komiteti për Politikë dhe Financa
PËRMES:	Mehmet Ballazhi Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit
NGA :	Lindita Ballazhi Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA:	Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2027-2029

I nderuar Kryesues i Kuvendit,
Të nderuar/a Anëtarë të Kuvendit Komunal,

Bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-048 neni 20,
Qarkoren Buxhetore 2027/01 me numër protokoli Nr.987/2026 e datës 15.05.2026, ju përcjellim
Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2027-2029.

Me respekt,



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

04/ 5236 /2026

KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2027-2029

1. Hyrje

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria e Republikës së Kosovës gjatë muajit maj të këtij vitit, ka aprovuar Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Qeveritare (KASH) për periudhën 2027 – 2029.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH 2027-2029) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2027, i cili do të miratohet nga Asambleja Komunale. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Pas hartimit nga Ministria e Financave të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2027 – 2029), pason edhe Qarkorja Buxhetore për gjitha Organizatat Buxhetore mbi bazën e së cilës të gjitha OB-të njoftohen mbi instruksionet e hartimit të buxheteve të tyre për periudhën 2027 – 2029.

Qarkorja Buxhetore 2027/01 ofron udhëzimet e para të përgatitjes së buxhetit komunal, përfshirë këtu kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë fillestarë të financimit për komunat për periudhën 2027 – 2029. Bazuar në kufijtë fillestarë të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore 2027/01, Autoritetet Komunale janë angazhuar në përgatitjen e KAB-it 2027-2029 të Organizatës Buxhetore - 659 Komuna Hani i Elezit.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale - KABK, siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KABK siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

KAB-i Komunal, është dokumenti i parë që i prinë procesit të hartimit të Buxhetit pas pranimit të Qarkores së parë Buxhetore që lansohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për çdo vit.

Kalendarin kohor të procesit buxhetorë sipas udhëzimeve të Qarkores Buxhetore 2027/01 po e paraqesim si vijon:

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendar kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

1. **30 Qershor:** Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029,
2. **30 Shtator:** Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitet 2027-2029 nga Kuvendi Komunal,
3. **30 Shtator:** pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dokumentet si në vijim:
 - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2027-2029, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - ✓ Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2027-2029 (kopje e shtypur prej SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.1.B - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes,
 - ✓ Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2027 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2028-2029 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabela 4.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve dhe huamarrjes,
 - ✓ Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - ✓ Tabelat e Buxhetimit sipas performancë,
 - ✓ Buxhetimi gjinor.

Më në detaje kemi paraqitur më poshtë fazat e procesit buxhetor komunal 2027:

1. Përgatitja e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029:

- Dokument bazik i nivelit të lartë strategjik komunal, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike.

2. Shqyrtimi i prioriteteve për programet komunale:

- Kryetari i Komunës, Drejtori i Financave dhe drejtorët e drejtorive komunale bëjnë shqyrtimin e politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre sektoriale.

3. Kufijtë fillestarë specifik për programet buxhetore:

- Rekomandohet se kufijtë fillestarë specifik të programeve duhet të përcaktohen para datës 01 Korrik 2026 bazuar në projeksionet e vendosura të Qarkores 2027/01 nga MFPT.

4. Dorëzimi i propozim buxhetit komunal sipas programeve:

- Drejtorët e drejtorive bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve, përfshirë politikat e reja si dhe opsionet për kursime të mundshme.
- 5. Dëgjimet buxhetore:**
- Seanca dëgjimore në secilën drejtori komunale me qëllim të shqyrtimit të buxheteve të propozuara si dhe dëgjime publike të hapura me publikun.
- 6. Shqyrtimi i buxhetit komunal nga Kuvendi Komunal:**
- Kryetari i Komunës përmes drejtorisë së Financave dorëzon propozim-buxhetin në Kuvendin Komunal për shqyrtim dhe aprovim, jo më vonë se 01 Shtator 2026.
- 7. Aprovimi i buxhetit të propozuar nga Kuvendi Komunal dhe dorëzimi në MFPT:**
- Propozim buxheti komunal për vitin 2027 i aprovuar nga Kuvendi Komunal dorëzohet në MFPT deri më 30 Shtator 2026.

2. KORNIZA FISKALE KOMUNALE PËR VITET 2027– 2029

Me Qarkoren Buxhetore 2027/01 janë përcaktuar Grantet Qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027 dhe orientimet për vitet 2028-2029, bazuar në prioritetet strategjike të Qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare. Po ashtu, Qarkorja përcakton edhe nivelin e të hyrave vetanake të komunave për vitin fiskal 2027 si dhe parashikimin afatmesëm 2028-2029. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave për vitin 2027, bazohen në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (LFPL) dhe Tabelën 1 të projeksioneve makro-fiskale, të përgatitur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve siç specifikohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP).

Procesi i buxhetit komunal merr parasysh këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël,
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës,
- Zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale, si dhe
- Përcaktimi i strukturës së shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve. Projektet kapitale shumë vjeçare duhet të raportohen në sistemin e Projekteve të Investimeve Publike (PIP) bazuar në performancë. Si rrjedhojë, nga komunat kërkohet të hartojnë strategjinë kornizë bazuar në synimet dhe objektivat të orientuara në rezultate.

Për vitin fiskal 2027 parashikohet një buxhet në lartësi prej 4,654,793.00 € apo një rritje prej 420,111.00 € apo për 9.92 % në raport me vitin 2026, kurse për vitin 2028 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 4,879,451.00 € apo një rritje prej 224,658.00 € ose 4.8 % në raport me vitin 2027, si dhe për vitin 2029 vlerësohet një buxhet prej 5,133.847.00 € apo një rritje prej 254,396.00 € apo për 5.2 % më i madh në raport me vitin 2028.

Analizuar financimin sipas llojeve të Granteve Qeveritare, në periudhën vijuese 2027-2029, financimi nga **Granti i përgjithshëm (GP)**, për vitin buxhetor 2027, do të kemi në dispozicion shumë prej 2,038,083.00 € apo një rritje prej 165,904.00 € apo 8.86 % në krahasim me vitin 2026.

Te **Granti Specifik i Arsimit**, në vitin 2027 parashikohet të jetë në shumë prej 1,469,055.00 € ose një rritje prej 39,409.00 € ose 2.76 % në krahasim me vitin 2026.

Te **Granti Specifik i Shëndetësisë**, i cili financim qeveritar është në shumë prej 653,150.00 € për vitin 2027, ku kemi një rritje në krahasim me vitin 2026 për 77,013.00 € apo 13.3%.

Te **të hyrat vetanake komunale (THVK)** për vitin 2027, parashikohet të jenë në lartësi prej 494,505.00 € apo një rritje prej 137,785.00 € apo 38.6 % në krahasim me vitin 2026, ndërsa për vitin 2028 THVK parashikohen të jenë në lartësi prej 510,738.00 € apo një rritje prej 16,233.00 € apo prej 3.2 % krahasuar me vitin 2027, ndërkaj për vitin 2029 kemi një vlerësim prej 537,073.00 € apo një rritje prej 26,335.00 € apo prej 5.1 % në krahasim me vitin 2028.

3. BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITET 2027-2029

Struktura e financimit komunal përfshin:

- Grantin e Përgjithshëm,
- Grantin specifik për Arsim,
- Grantin specifik për Shëndetësi,
- Projektionet e të hyrave vetanake nga Komunitat.

4.1.1 Granti i përgjithshëm

Granti i përgjithshëm për vitin 2027 parashikohet të jetë në shumë prej 2,038,083.00 €.

Financimi i shërbimeve sociale si kompetencë e transferuar nga MPFVLÇ në komuna përfshihet në kuadër të grantit të përgjithshëm të komunës. Të punësuarit në administratën e Drejtorive Komunale për Arsim para universitar dhe Shëndetësi primare financohen nga granti i përgjithshëm në komuna. Po ashtu, nga granti i përgjithshëm do të plotësohen edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetësi kur është e nevojshme. Në tabelën në vijim është pasqyruar si është përcaktuar Granti i Përgjithshëm për periudhën 2027-2029.

Shpërndarja e grantit të përgjithshëm për Komunën Hani i Elezit për vitet 2027-2029

Komuna	Popullsia	89%	Madhësia Gjeografike	0.76%	Popullsia Pakicë	0.01%	Shuma Fikse (140,000 - 1€)	Shuma për popullsi 89%	Shuma për madhësi gjeografike (6%)	Shuma për popullsi pakicë në komuna (3%)	Shuma për Komunitet me popullsi pakicë (2%)	GP për vitin 2027	GP për vitin 2028	GP për vitin 2029
Hani i Elezit	8,533	0.53%	83.13	0.76%	16	0.01%	131,467	1,737,405	167,681	1,530	-	2,038,083	2,182,842	2,345,327

Tabela 1: Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm 2027-2029

4.1.2 *Granti Specifik për Arsim Parauniversitar*

Granti Specifik për Arsim para universitar sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit para universitar të MASH për vitin 2027-2029. Formula trajton nivelin e arsimit para fillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriterë:

- ✓ Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2025/2026;
- ✓ Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë 1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr. 22/2013 të MASHTI-it);
- ✓ Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë 1:14.2;
- ✓ Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- ✓ Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë 1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- ✓ Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- ✓ Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- ✓ Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin para fillor dhe fillor;
- ✓ Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm
- ✓ Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- ✓ Kalkulimi i pagave dhe shtesave është bazuar në Ligjin për Paga në sektorin Publik;
- ✓ Shërbimi profesional Pedagogjik/Psikologjik;
- ✓ Koordinatorët e cilësisë;
- ✓ Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë para fillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- ✓ Kapitallet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;

Sipas MASH-it është raportuar numri për 7,523 nxënës më pak në arsim para universitar krahasuar me vitin paraprak.

Nr	Komuna Hani i Elezit	
1	Total numri i nxënësve/eve	1,630
2	Numri i mësimeve/eve, personelit admin dhe ndihmës	148
3	Stafi i aprovuar me LB për 2026 - Arsimi	142
4	Ndryshimi i stafit	6
5	Numri i stafit i marrë për bazë llogaritjen e grantit – bazuar në propozimin e Mashtit	148
6	Paga mesatare 804 €	1,392,435
7	Buxheti i nevojshëm për paga në vitin 2027 sipas stafit të lejuar	1,332,306
8	Mallra dhe Shërbime	10,750
9	Mallra dhe Shërbime për nxënës	36,732
10	Mallra dhe shërbime për fëmijë 2 – 5 vjeç	428
11	Transporti i nxënësve 0-9	17,607
12	Gjithsej Mallrat dhe Shërbimet	65,517
13	Shpenzime Kapitale	11,102
14	GRANTI SPECIFIK PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR VITIN 2027	1,469,055
15	GRANTI SPECIFIK PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR VITIN 2028	1,513,126
16	GRANTI SPECIFIK PËR ARSIMIN PARAUNIVERSITAR PËR VITIN 2029	1,558,520

Tabela 2: Shpërndarja e Grantit Specifik për Arsim Parauniversitar 2027-2029

4.1.3 Granti Specifik për Shëndetësi Primare për vitet 2027-2029

Nr.	Komuna Hani i Elezit	Totali
1	Popullësia	8,533
2	Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF)	1
3	Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)	1
4	Numri total i stafit profesional	40
5	Numri total i stafit administrativ	23
6	Numri total i stafit	63
7	Numri i stafit në bazë të LB 2026	46
8	Ndryshimi i stafit	17
9	Numri i stafit i marrë për bazë në llogaritjen e grantit - bazuar në propozimin e MSH	63
10	Total paga dhe shtesa për vitin 2027 (mesatarja 996 euro)	534,523
11	Buxheti i nevojshëm për paga në vitin 2027 sipas stafit të lejuar	755,964
12	Mallra dhe Shërbime	109,027
13	Shpenzime komunale	9,600
14	Granti për Shëndetësi Primare për vitin 2027	653,150
15	Granti për Shëndetësi Primare për vitin 2027	672,745
16	Granti për Shëndetësi Primare për vitin 2028	692,927

Tabela 3: Shpërndarja e Grantit Specifik për Shëndetësi Primare 2027-2029

4.1.4 Projektionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2027 dhe parashikimet 2028-2029

Projeksionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2027 bazuar, në vlerësimet makro-fiskale, janë në shumë prej 132.2 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Në këtë projektion sa i përket të hyrave tatimore janë marrë parasysh të hyrat nga tatimi në pronat e paluajtshme, ndërsa për të hyrat jo tatimore është marr për bazë mesatarja e realizimit të të hyrave jo tatimore në tri vitet e fundit dhe parashikimet e komunave mbi trendin e rritjes së të hyrave jo tatimore.

Nr	Komuna Hani i Elezit	Total
1	Tatimi në pronë 2027	159,958
2	Tatimi në tokë 2027	45,245
3	Tatimi në pronë 2028	161,558
4	Tatimi në tokë 2028	45,471
5	Tatimi në pronë 2029	162,365
6	Tatimi në tokë 2029	45,698
7	Të hyrat jotatimore 2027	289,303
8	Të hyrat jotatimore 2027	303,710
9	Të hyrat jotatimore 2028	329,009
10	Projeksionet për vitin 2027	494,505
11	Projeksionet për vitin 2028	510,738
12	Projeksionet për vitin 2029	537,073

Tabela 4. Projektioni i të hyrave vetake 2027-2029

4. PERSPEKTIVA E POLITIKAVE FISKALE KOMUNALE

Në hartimin e perspektivës së politikave fiskale komunale jemi bazuar në informatat dhe analizat e KASH-it 2027-2029, në të cilin dokument projeksionet makro-fiskale parashohin një përmirësim të konsiderueshëm në vjeljen e të hyrave vetanake komunale (THVK), në rritjen e efikasitetit të shpenzimeve të parasë publike, në zbatimin e kursimeve buxhetore, etj.

Financimi komunal nga të hyrat vetanake komunale për vitin 2027, të parashikuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2027-2029, bazohet në dispozitat e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal.

Burimet e të hyrave	Buxheti 2026	Planifikimi për vitin 2027	Vlerësimet 2028	Vlerësimet 2029
Granti i Përgjithshëm	1,872,179.00	2,038,083.00	2,182,842.00	2,345,327.00
Granti specifik i Arsimit	1,429,646.00	1,469,055.00	1,513,126.00	1,558,520.00
Granti specifik i Shëndetësisë	576,137.00	653,150.00	672,745.00	692,927.00
Të hyrat vetanake	356,720.00	494,505.00	510,738.00	537,073.00
Totali	4,234,682.00	4,654,793.00	4,879,451.00	5,133,847.00

Tabela 5: Burimet e financimit për vitet 2027-2029

Duke u bazuar në trendet makro-ekonomike dhe projeksionet e dhëna në nivel të vendit dhe bazës së të dhënave numerike në vlerësimet tona të hershme buxhetore për periudhën 2027-2029, buxheti i komunës do të shënoj trende të rritjes.

Në vitin 2027 do të kemi një rritje prej 9.9% ose për 420,111.00 € në raport me vitin 2026, kurse për vitin 2028 kemi një parashikim të buxhetit në lartësi prej 4,879,451.00 € apo një rritje prej 224,658.00 € ose 4.8 % në raport me vitin 2027, si dhe për vitin 2029 vlerësohet një buxhet prej 5,133,847.00 € apo një rritje prej 254,396.00 € apo për 5.2% më i madh në raport me vitin 2028.

Në vitin e parë buxhetor 2027 sipas këtyre parametrave, do të kemi këtë strukturë buxhetore të sigurimit të mjeteve dhe atë si vijon:

- ❖ nga Granti i Përgjithshëm me pjesëmarrje prej 2,038,083.00 € apo 43.7 %,
- ❖ nga Granti Specifik i Arsimit me pjesëmarrje 1,469,055.00 apo 31.5 %,
- ❖ nga Granti Specifik i Shëndetësisë me pjesëmarrje 653,150.00 apo 14.03 %
- ❖ nga të Hyrat Vetanake Komunale me pjesëmarrje prej 494,505.00 € apo 10.6 %,
- ❖ totali (Grantet + THVK) me pjesëmarrje prej **4,654,793.00 €** apo **100.00 %**.




Figura 1: Paraqitja grafike e burimeve të financimit 2027-2029

4.1 Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2027-2029

Të hyrat buxhetore komunale realizohen në bazë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores për Taksa Komunale, Rregullores së Tatimit në Pronën e Paluajtshme si dhe dispozitave tjera ligjore të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale me të cilat komuna është e autorizuar dhe ka të drejtë t'i inkasoj.

Bazën e të hyrave komunale e përbëjnë Tatimi në Pronë dhe në Tokë, si gjenerator kryesor i të hyrave vetanake komunale (THVK), e që këtë lloj të hyre komuna pas grumbullimit duhet ekskluzivisht të shpenzoj vetëm për qëllime të realizimit të projekteve kapitale si, në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, kanalizime dhe investime tjera, që thënë ndryshe këto mjete pas inkasimit menjëherë i'u rikthehen qytetarëve/eve apo tatimpaguesëve/eve përmes formës së investimeve të destinuara për ngritjen e infrastrukturës komunale dhe mirëqenies sociale.

Të hyrat e komunës përbëhen kryesisht nga këto lloje të të hyrave:

- Tatimi në pronë;
- Tatimi në tokë;
- Taksat për ushtrim të veprimtarisë biznesore;
- Taksat për leje të ndërtimit;
- Taksa për shfrytëzimin e pronës komunale;
- Taksa për regjistrimin e automjeteve motorike;
- Taksat administrative komunale (taksa për dokumentacionin lidhur me statusin shoqëror si,çertifikatat e lindjes, martesës, vdekjes, shtetësisë etj);
- Bashkë-pagesat në arsim;
- Bashkë-pagesat në shëndetësi dhe
- Të hyra tjera.

Nr	Përshkrimi	Viti 2026	Planifikimi 2027	Vlerësimi 2028	Vlerësimi 2029
A	B	C	D	E	F
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	4,234,682.00	4,654,793.00	4,879,451.00	5,133,847.00
1.1	TË HYRAT VETANAKE	356,720.00	494,505.00	510,738.00	537,073.00
1.1.1	Tatimi në pronë	149,145.00	159,958.00	161,558.00	162,365.00
1.1.2	Tatimi në tokë	37,392.00	45,245.00	45,471.00	45,698.00
1.1.3	Taksat Komunale	143,183.00	164,302.00	192,500.00	187,357.00
	<i>Licencat dhe lejet</i>	5,800.00	5,000.00	6,000.00	7,357.00
	<i>Certifikatat dhe dokumentet zyrtare</i>	8,000.00	5,000.00	8,500.00	8,000.00
	<i>Taksat e pajisjeve motorike</i>	20,000.00	27,000.00	27,000.00	26,000.00
	<i>Lejet per ndërtesa</i>	24,383.00	25,302.00	26,000.00	25,000.00
	<i>Taksat tjera komunale</i>	85,000.00	102,000.00	125,000.00	121,000.00
1.1.4	Ngarkesat Komunale	27,000.00	125,000.00	111,209.00	141,653.00
	<i>Të hyrat nga qiraja</i>	3,000.00	5,000.00	4,000.00	5,000.00
	<i>Bashkë-pagesat për Arsim</i>	15,000.00	25,000.00	30,000.00	26,000.00
	<i>Bashkë-pagesat për Shëndetësi</i>	9,000.00	10,000.00	10,000.00	15,653.00
	<i>Ngarkesat rregullatore</i>	-		-	-
	<i>Ngarkesat tjera komunale</i>	-		-	-
1.1.5	Të hyrat tjera (gjobat)	-	85,000.00	67,209.00	95,000.00
1.2	TRANSFERET QE VERITARE	3,877,962.00	4,160,288.00	4,368,713.00	4,596,774.00
1.2.1	Granti i përgjithshëm	1,872,179.00	2,038,083.00	2,182,842.00	2,345,327.00
1.2.2	Granti për Arsim	1,429,646.00	1,469,055.00	1,513,126.00	1,558,520.00
1.2.3	Granti për Shëndetësi	576,137.00	653,150.00	672,745.00	692,927.00

Tabela 6. Plani Afatmesëm i THV 2027-2029

Përveç të hyrave nga tatimi në pronë dhe në tokë kemi edhe taksat tjera komunale të cilat kontribuojnë dukshëm në krijimin e THVK, si: taksat për ushtrim të veprimtarisë së biznesit, taksa për regjistrimin e automjeteve motorike, taksat për shfrytëzimin e pronës komunale, taksa për lejet e ndërtimit, taksa për shfrytëzim të pronës publike, bashkëpagesat në Arsim dhe Shëndetësi etj.

Duke u bazuar në të dhënat e prezentuara në tabelën e sipërme – Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal, THVK për vitin aktual buxhetor 2026 janë të planifikuar në shumë prej 356,720.00 €, ndërkaq për vitet vijuese 2027-2029, përkatësisht në vitin e parë të planifikimit afatmesëm 2027, parashikohen që THVK të jenë në shumë prej 494,505.00 € ose një rritje prej 137,785.00 € apo 38.6 %, në raport me vitin 2026, pastaj në vitin 2028 shuma e planifikuar është 510,738.00 € ose një rritje prej 16,233.00 € apo prej 3.2 % në raport me vitin 2027 dhe në vitin e tretë 2029 vlerësohet të jetë shuma prej 537,073.00 € ose një rritje prej 26,335.00 € apo prej 5.1%, në krahasim me vitin 2028. Mbështetur në të dhënat e pasqyruara në tabelarë dhe nga e gjithë kjo që u potencua, mund të konstatohet se përmbushja e të hyrave të përgjithshme buxhetore komunale për periudhën e ardhshme afatmesme 2027-2029, krahas varshmërisë së mëtejme që do të kemi nga alokimet e Granteve Qeveritare, gjithësesi do të jemi të varur edhe nga shkalla e realizimit të të hyrave komunale, e që këto të fundit kanë ndikim edhe në shkallën e ekzekutimit të kategorisë së shpenzimeve investime kapitale, të cilat do të financohen edhe nga ky burim i të hyrave.

6.KORNIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE

6.1 Shpenzimet buxhetore sipas programeve dhe kategorive ekonomike të shpenzimeve

Me vlerësimet e hershme të shpenzimeve buxhetore, në KABK për 2027-2029, janë të përfshira projeksionet orientuese sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore mbi bazën e ndarjës buxhetore në pesë (5) kategori kryesore të shpenzimeve për tre vitet e ardhshme të shpenzimeve të përgjithshme të komunës.

Këto projeksione dhe vlerësime të shpenzimeve buxhetore për vitet 2027-2029, janë të bazuara në politikat dhe prioritetet e përcaktuara më parë nga programet buxhetore dhe konsolidimi i tyre në nivel të organizatës buxhetore të komunës.

Për vitet 2027-2029, shpenzimet e përgjithshme operative buxhetore do të përqëndrohen para se gjithash në mbulimin e shpenzimeve nga ushtrimi i kompetencave komunale dhe funksionimin sa më efikas të tre (3) sektorëve publik si: të administratës komunale, arsimit, si dhe të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

Ndërsa, te shpenzimet kapitale bazuar në kërkesat e parashtruara nga programet buxhetore, do të bëhen përpjekjet maksimale në sigurimin e mjeteve buxhetore për vitet 2027-2029, duke u krijuar një konsum investiv me një pjesëmarrje në strukturën e shpenzimeve të përgjithshme buxhetore të komunës.

Në sferën e realizimit të projekteve kapitale 2027-2029, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet edhe bashkëpunimit me donatorët, qoftë financimit nga Ministrinë e Linjës, financimit të jashtëm përmes fondeve IPA (Instrumenti për Asistencë Para - Anëtarësimi) për shtimin e masës së mjeteve për investime kapitale, për bashkëfinancim të projekteve investive publike (PIP).

6.2 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2027

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total 2027
Zyra e Kryetarit	13	132,380.00	40,000.00	0	70,000.00	0	242,380.00
Zyra e Kuvendit Komunal	15	150,000.00	15,000.00	0	0	0	165,000.00
Administrata dhe Personeli	16	136,412.00	70,000.00	55,000.00	0	0	261,412.00
Buxheti dhe Financat	10	88,075.00	4,000.00	0	0	0	92,075.00
Shërbimet Publike dhe Emergjenca	10	99,222.00	115,500.00	3,000.00	15,000.00	117,816.00	350,538.00
Zyra Komunale për Komunitete	1	9,287.00	0	0	0	0	9,287.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	2	20,665.00	2,000.00	0	30,000.00	0	52,665.00
Zhvillimi Ekonomik	4	39,590.00	10,000.00	0	25,000.00	182,000.00	256,590.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	82,250.00	15,000.00	0	0	355,000.00	452,250.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	64	746,504.00	109,027.00	15,000.00	0.00	55,000.00	925,531.00
Administrata e shëndetësisë	2	20,540.00	0	0	0	0	20,540.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	62	725,964.00	109,027.00	15,000.00	0	55,000.00	904,991.00
Shërbimet sociale	3	28,250.00	2,500.00	3,000.00	0		33,750.00
Kultura, Rinia dhe Sportet	5	47,340.00	30,000.00	15,000.00	35,000.00	35,000.00	162,340.00
Arsimi dhe Shkenca	152	1,385,475.00	155,500.00	20,000.00	40,000.00	50,000.00	1,650,975.00
Administrata e arsimit	3	32,535.00	66,000.00	0	40,000.00	50,000.00	188,535.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	14	115,550.00	16,000.00	7,000.00	0	0	138,550.00
Arsimi fillor	111	1,018,250.00	65,000.00	9,500.00	0	0	1,092,750.00
Arsimi i mesëm	24	219,140.00	8,500.00	3,500.00	0	0	231,140.00
TOTALI	303	2,965,450.00	568,527.00	111,000.00	215,000.00	794,816.00	4,654,793.00

6.3 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2028

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total 2028
Zyra e Kryetarit	13	134,380.00	40,000.00	0	50,000.00	0	224,380.00
Zyra e Kuvendit Komunal	15	153,000.00	15,500.00	0	0	0	168,500.00
Administrata dhe Personeli	16	138,412.00	80,000.00	55,000.00	0	0	273,412.00
Buxheti dhe Financat	10	90,100.00	4,000.00	0	0	0	94,100.00
Shërbimet Publike dhe Emergjenca	10	100,250.00	120,000.00	4,000.00	20,000.00	120,000.00	364,250.00
Zyra Komunale për Komunitete	1	9,456.00	500	0	0	0	9,956.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	2	20,890.00	2,000.00	0	50,000.00	0	72,890.00
Zhvillimi Ekonomik	4	40,100.00	10,000.00	0	25,000.00	150,000.00	225,100.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	83,250.00	15,000.00	0	0	492,424.00	590,674.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	64	776,814.00	100,500.00	15,000.00	0.00	10,000.00	902,314.00
Administrata e shëndetësisë	2	20,850.00	500	0	0	0	21,350.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	62	755,964.00	100,000.00	15,000.00	0	10,000.00	880,964.00
Shërbimet sociale	3	28,250.00	2,500.00	4,000.00	0		34,750.00
Kultura, Rinia dhe Sportet	5	47,340.00	30,000.00	16,000.00	50,000.00	50,000.00	193,340.00
Arsimi dhe Shkenca	152	1,398,285.00	155,500.00	22,000.00	50,000.00	100,000.00	1,725,785.00
Administrata e arsimit	3	32,535.00	66,000.00	0	50,000.00	100,000.00	248,535.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	14	120,500.00	16,000.00	8,000.00	0	0	144,500.00
Arsimi fillor	111	1,025,000.00	65,000.00	9,500.00	0	0	1,099,500.00
Arsimi i mesëm	24	220,250.00	8,500.00	4,500.00	0	0	233,250.00
TOTALI	303	3,020,527.00	575,500.00	116,000.00	245,000.00	922,424.00	4,879,451.00

6.4 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2029

Përshkrimi	Stafi	Pagat dhe shtesat	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Total 2029
Zyra e Kryetarit	13	134,380.00	55,000.00	0	50,000.00	0	239,380.00
Zyra e Kuvendit Komunal	15	153,000.00	17,000.00	0	0	0	170,000.00
Administrata dhe Personeli	16	138,412.00	85,000.00	60,000.00	0	0	283,412.00
Buxheti dhe Financat	10	90,100.00	5,000.00	0	0	0	95,100.00
Shërbimet Publike dhe Emergjencia	10	100,250.00	125,000.00	5,000.00	25,000.00	135,000.00	390,250.00
Zyra Komunale për Komunitete	1	9,456.00	500	0	0	0	9,956.00
Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural	2	20,890.00	5,000.00	0	60,000.00	0	85,890.00
Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi	4	40,100.00	15,000.00	0	25,000.00	150,000.00	230,100.00
Planifikimi Urban dhe Mjedisi	8	83,250.00	25,000.00	0	0	568,320.00	676,570.00
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	64	776,814.00	105,500.00	20,000.00	0.00	20,000.00	922,314.00
Administrata e shëndetësisë	2	20,850.00	500	0	0	0	21,350.00
Shërbimet e shëndetësisë primare	62	755,964.00	105,000.00	20,000.00	0	20,000.00	900,964.00
Shërbimet sociale	3	28,250.00	4,000.00	5,000.00	0		37,250.00
Kultura, Rinia dhe Sportet	5	47,340.00	35,000.00	20,000.00	50,000.00	50,000.00	202,340.00
Arsimi dhe Shkenca	152	1,398,285.00	185,000.00	28,000.00	60,000.00	120,000.00	1,791,285.00
Administrata e arsimit	3	32,535.00	70,000.00	0	60,000.00	120,000.00	282,535.00
Arsimi parashkollor dhe çerdhet	14	120,500.00	20,000.00	10,000.00	0	0	150,500.00
Arsimi fillor	111	1,025,000.00	85,000.00	12,000.00	0	0	1,122,000.00
Arsimi i mesëm	24	220,250.00	10,000.00	6,000.00	0	0	236,250.00
TOTALI	303	3,020,527.00	662,000.00	138,000.00	270,000.00	1,043,320.00	5,133,847.00

5. Financimi i investimeve kapitale komunale për vitet 2027-2029

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2027	Vlerësimi 2028	Vlerësimi 2029	Shpenzime totale 2027- 2029
	Hani i Elezit - 659	794,816.00	922,424.00	1,043,320.00	2,760,560.00
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	794,816.00	922,424.00	1,043,320.00	2,760,560.00
180	Shërbimet publike dhe emergjenca	117,816.00	120,000.00	135,000.00	372,816.00
18444	Parandalimi dhe inspektimi i zjarreve	117,816.00	120,000.00	135,000.00	372,816.00
1	Ndriçimi publik në fshatrat: Pustenik, Dimcë, Gorancë, Krivenik, Seçishtë, Rezhancë, Paldenicë, Dermjak	0.00	15,000.00	20,000.00	35,000.00
2	Vendosja e tabelës digjitalë në rrugën "Dëshmorët e Kombit"	20,000.00	10,000.00	0.00	30,000.00
3	Hapjen e trasesë së rrjetit të ujësjellësit të Gllloboçicës	20,000.00	10,000.00	0.00	30,000.00
4	Ndërtimi i mbulojës pritëse për udhëtarë në rr. Adem Jashari	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00
5	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik	5,000.00	20,000.00	50,000.00	75,000.00
6	Shtimi i kapaciteteve të ujit në Lagjen e Re dhe në Han të Elezit	17,816.00	15,000.00	10,000.00	42,816.00
7	Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte)	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
8	Rregullimi i rezervuarit të ujit në fshatin Seçishtë	10,000.00	15000	25000	50,000.00
9	Rregullimi i krojeve publike në Han të Elezit dhe në fshatrat: Dromjak, Seçishtë, Krivenik, Dimcë, Paldenicë, Pustenik dhe Rezhancë	5,000.00	15000	5000	25,000.00
480	Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik	182,000.00	150,000.00	150,000.00	482,000.00
48035	Zhvillimi Ekonomik	182,000.00	150,000.00	150,000.00	482,000.00
10	Ndërtimi i tregut ditor në Han të Elezit	32,000.00	60,000.00	55,000.00	147,000.00
11	Ndërtimi i Hanit të vjetër në 3D	15,000.00	20,000.00	25,000.00	60,000.00
12	Rregullimi i sheshit të qytetit në Han të Elezit	135,000.00	70,000.00	70,000.00	275,000.00
660	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	355,000.00	492,424.00	568,320.00	1,415,744.00
66480	Planifikimi Urban dhe Inspeksioni	355,000.00	492,424.00	568,320.00	1,415,744.00
13	Riasfaltimi dhe rikubëzimi i rrugëve "Dëshmorët e Kombit", "Xhemsedin Suma" dhe "Nuri Bushi"	200,000.00	0.00	0.00	200,000.00
14	Rregullimi i prockave dhe kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë dhe Seçishtë	10,000.00	15,000.00	5,000.00	30,000.00
15	Mjete të lira për bashkëinvestime	10,000.00	20,000.00	25,000.00	55,000.00
16	Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë	10,000.00	25,000.00	35,000.00	70,000.00
17	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fshatrat: Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë	25,000.00	40,500.00	25,000.00	90,500.00

18	Ndërtimi i mbikalimeve në Rr. Martirët Bushi dhe Rr. Lepenci	0.00	50,000.00	30,000.00	80,000.00
19	Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udhë e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë	0.00	27,000.00	28,491.00	55,491.00
20	Asfaltimi i rrugës transit në fshatin Gorancë	0	100,000.00	150,000.00	250,000.00
21	Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pusteni, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik	20,000.00	65,000.00	60,000.00	145,000.00
22	Ndërtimi (Rihapja, zgjerimi) dhe asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Paldenicë, Pusteni, Seçishtë, Gorancë, Dimcë, Krivenik	0.00	60,000.00	50,000.00	110,000.00
23	Fabrika e ujit nga ujësjellësi i Dimcës, Shtëpia e Kulturës - Imri Curri, Stadiumi i qytetit - Suad Brava - Shpronësim	60,000.00	20,000.00	25,000.00	105,000.00
24	Vendosja e ekranit për prezantimin e rezultateve të ndotjes së ajrit në rrugën Nuri Bushi	0.00	10,000.00	89829	99,829.00
25	Rregullimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) në rr. Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rr. Gafurr Loku fsh. Paldenicë	20,000.00	30,000.00	0	50,000.00
26	Ndërtimi dhe rregullimi i këndeve të lojërave në Han të Elezit dhe fshatrat Gorancë, Paldenicë, Seçishtë	0.00	15000	10,000.00	25,000.00
27	Ndërtimi (shtrimi me zhavor) i rrugës në Seçishtë kah Vorbat	0.00	11,924.00	10,000.00	21,924.00
28	Ndërtimi i rrugës Hani i Elezit - Dimcë	0.00		25,000.00	25,000.00
29	Rregullimi i rrugës Fujza - Vërtomicë	0.00	3,000.00		3,000.00
730	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	55,000.00	10,000.00	20,000.00	85,000.00
75050	Shërbimet e shëndetësisë primare	55,000.00	10,000.00	20,000.00	85,000.00
30	Rregullimi i infrastrukturës së QKMF-së në Han të Elezit dhe AMF-së në fshatin Gorancë	5,000.00	10,000.00	20,000.00	35,000.00
31	Blerja e një autoambulance	50,000.00	0.00	0.00	50,000.00
920	Arsimi dhe Shkenca	50,000.00	100,000.00	120,000.00	270,000.00
92175	Administrata	50,000.00	100,000.00	120,000.00	270,000.00
32	Rregullimi i infrastrukturës shkollore në SHML - Dardania, SHFMU - Ilaz Thaçi, SHFMU - Kështjella e Diturisë dhe SHMFU - Veli Ballazhi, Institucioni Parashkollor "Ardhmëria"	50,000.00	45,000.00	5,000.00	100,000.00
33	Ndërtimi i objektit të SHFMU në Lagjen e Re	0.00	50,000.00	20,000.00	70,000.00
34	Ndërtimi i çerdhës në Lagjen e Re	0.00	5,000.00	95,000.00	100,000.00
850	Kulturë, Rini dhe Sport	35,000.00	50,000.00	50,000.00	135,000.00
85035	Shërbimet Kulturore	35,000.00	50,000.00	50,000.00	135,000.00
35	Rikonstruksionimi i stadiumit "Suad Brava"	10,000.00	15,000.00	25,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i skenës verore në Qendrën Kulturore "Imri Curri"	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00
37	Renovimi i sallave sportive në shkollat: SHFMU "Ilaz Thaçi", SHFMU "Veli Ballazhi" dhe "Kështjella e Diturisë"	10,000.00	35,000.00	25,000.00	70,000.00



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA - MUNICIPALITY
HANI I ELEZIT



Nr. 04/ 5585 /2026

DATA :	22.06.2026
PËR :	Kuvendin Komunal
NGA:	["] <i>pl</i> Mehmet Ballazhi Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
PËRMES :	Lindita Ballazhi <i>L Ballazhi</i> Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa
LËNDA :	Kërkesë për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore Shpenzime Kapitale

I nderuar Kryesues i Kuvendit,
Të nderuar/a Anëtarë të Kuvendit Komunal,

Në bazë të Ligjit Nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, neni 15, paragrafi 11, dhe në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, 12, 40, Drejtoria për Buxhet dhe Financa kërkon aprovimin e kërkesës për rialokim të mjeteve në kategorinë buxhetore të Shpenzimeve Kapitale.

Rialokimi i mjeteve në kategorinë buxhetore shpenzime kapitale është në shumë prej 129,880.00 €, nga fondi (10) apo Granti Qeveritar.

Me respekt!

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë shpenzime kapitale, burimi i financimit (10):

Në kuadër të Nën-programit buxhetor Parandalimi dhe Inspektimi i Zjarrit (18444), kodi funksional (0320):

Rialokohet nga projektet:

1. Ndërtimi (ngritja e deponisë) për mbetje të ngurta (inerte) me kod (55036), në shumë prej 11,250.00 Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatërat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik në shumë prej 11,250.00 €.

Rialokohet në projektin:

1. Riparimi i rrugëve dhe trotuareve në Han të Elezit dhe në fshatërat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Rezhancë, Krivenik me kod (55035), në shumë prej 11,250.00 €.

Në kuadër të Nën-programit buxhetor Zhvillimi Ekonomik (48075), kodi funksional (0473):

Rialokohet nga projekti:

1. “Ndërtimi i tregut ditor në Han të Elezit” kodi (20976), shuma prej 17,550.00 €.

Rialokohet në projektin:

1. “Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenik, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë” kodi (55046), në shumë prej 17,550.00 €.

Në kuadër të Nën-programit Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66480), kodi funksional (0620).

Rialokohen nga projektet:

1. “Mjete të lira për bashkëinvestime” kodi (41641,) shuma prej 9,100.00 €, fondi burimor (10),
2. “Rregullimi i kanalizimeve në Hanit të Elezit në Rr. Isa Berisha dhe zonat rurale në fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Krivenik, Dimcë”, kodi (51581) shuma prej 11,500.00 €, fondi burimor (10),
3. “Ndërtimi i rrugës në Seçishtë kah Vorbat”, kodi (56251), shuma prej 30,000.00 €, fondi burimor (10),
4. “Rregullimi i rrugës Fujza - Vërtomicë”, kodi (56256), në shumë prej 15,480.00 €, fondi burimor (10),
5. “Rregulimi i hapësirave publike (me kubëza betoni dhe gjelbërim) ne rr.Dëshmorët e Kombit, Isa Berisha në Han të Elezit dhe rr.Gafur Loku-fsh.Paldenicë” kodi (55043), në shumë prej 20,000.00 €, fondi burimor (10),
6. “Rregullimi i prockave dhe i kanalizimeve atmosferike në fshatrat: Paldenicë, Rezhancë,dhe Seçishtë”, kodi i projektit (55045), në shumë prej 15,000.00 €, fondi burimor (10),

Rialokohen në projektet:

1. “Ndërtimi i trotuareve për këmbësor në Han të Elezit në Rr. Adem Jashari, Udha e Shkronjave, Driton Loku, Paldenicë”, kodi (53370), në shumë prej 28,078.00 €,
2. “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat: Paldenicë, Seçishtë, Dimcë, Pustenik, Gorancë, Dermjak, Rezhancë, Krivenik” kodi (53471), në shumë prej 28,472.00 €,
3. “Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagja e Re dhe në fshatrat Paldenicë, Dermjak, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik, Dimcë”, kodi (52894), në shumë prej 10,837.00 €,
4. “Shtrimi me zhavor i rrugës prej burimit të fshatit Seçishtë deri te Lloka”, kodi (56287), në shumë prej 12,000.00 € dhe
5. Shtrimi me kubëza betoni i rrugës që lidh fshatin Rezhancë me varrezat, kodi (21032), në shumë prej 21,693.00 €.



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5254/2026

DATA:	10.06.2026
PËR:	Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin e Komunës.
NGA:	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z.Florim Shkreta
LËNDA:	Shkresë përcjellëse: Propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2027.

Me anë të kësaj shkrese ju përcjellim Propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2027.

Me respekt



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. _____/2026

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë06.2026 merr:

PROPOZIM VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË
KOMUNËS PËR VITIN 2027

1. Kuvendi i komunës miratoi Propozim vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2027.

2. Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 5 (pesë) anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

- 2.1.
- 2.2.
- 2.3.
- 2.4.
- 2.5.

3. Ky propozim vendim hynë në fuqi 30 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës

Me këtë propozim vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Anëtarët e grupit punues,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



REPUBLIKA E KOSOVËS--REPUBLIC OF KOSOVA
MUNICIPALITY OF ELEZ HAN
KOMUNA HANI I ELEZIT



DREJTORIA PËR URBANIZËM, KADASTER DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

5250
Nr.06/___2026

DATE:	10.06.2026
PËR:	KPF dhe Kuvendur Komunal
PËRMES:	z. Mehmet Ballazhi - Kryetar i Komunës Hani i Elezit
NGA:	Nexhmedin Daci - Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
TEMA:	Shkresë përcjellëse- Propozim vendim

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese përcjellëse po ju përcjellim propozim vendimin për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të Kuvendit të Komunës Hani i Elezit me nr.3444/2013 të dt.27.06.2013 si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit me nr.2457/2023 të dt.30.03.2023 mbi shpalljen interes i përgjithshëm publik të paluajtshmërive- prona shoqërore, të cilat menaxhohen nga Axhencioni Kosovar i Privatizimit (AKP).

Bashkëlidhur me shkresën keni propozim vendimin.

Me Respekt.



Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 pika (s) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/4 Qershor 2008), Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 11, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë xx.06.2026 merr:

PROPZIM-VENDIM

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e pjesshëm të vendimit respektivisht pikave a, b, c, d, k, l, m, n, p, q dhe pika j të vendimit të Kuvendit të Komunës me nr.01/Nr.3444/2013 të dt.27.06.2013 me të cilin shpallen interes i përgjithshëm publik parcelet si më poshtë vijon:

Pika (a): parcela Nr.92-7 (nr. i ri kadastral 92-56) pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë tokë jo pjellore në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit" me sip. prej 00 00 94 ha e evidentuar në qertifikatë pronësie nr. UL-73317036-00006 dhe nr. i ri i qertifikatës P-73317036-000092-56, zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (b): parcela Nr.92-9, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë tokë jo pjellore, në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit" me sipërfaqe 00 02 50 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie UL-73317036-00006 nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00092-9 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (c): parcela Nr.93-6 (nr. i ri kadastral 93-26) pronë shoqërore, zonë urbane me kulturë Infrastruktura-Rrugë, në vendin e quajtur "Xehrorja e Llaporit" me sipërfaqe 00 04 73 ha e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006 nr. i ri qertifikatës P-733317036-00093-26 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (d): parcela Nr.300-2, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë Infrastruktura- Rrugë në vendin e quajtur "Fabrika e Qimentos" me sipërfaqe prej 00 55 00 ha e evidentuar në qertifikatë pronësie nr. UL- 733117036-00006 nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00300-2 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (k): parcela Nr.332-2, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë kullosë e kl.5 (pesë) në vendin e quajtur "Fabrika e Qimentos" me sipërfaqe prej 00 13 49 ha e evidentuar në qertifikatë pronësie nr. UL73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00332-2 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (l): parcela Nr.335-2 pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë tokë jopjellore në vendin e quajtur "Fabrika e Qimentos", me sipërfaqe prej 00 03 46 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie nr. UL-73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00335-2, zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (m): parcela Nr.348-2, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë kullosë e kl.5 (pesë), në vendin e quajtur "Draqa" me sipërfaqe 00 04 27 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00348-2 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (n): parcela Nr.349-8, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë kullosë e kl.5 (pesë) në vendin e quajtur "Draqa" me sipërfaqe 00 02 85 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00349-8 zona kadastrale Hani i Elezit,

Pika (p): parcela Nr.351-2, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë livadh i kl.5 (pesë) në vendin e quajtur "Draqa" me sipërfaqe prej 00 02 87 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00351-2 zona kadastrale Hani i Elezit, dhe:

Pika (q): parcela Nr.351-3, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë livadh i kl.5 (pesë) në vendin e quajtur "Draqa" me sipërfaqe prej 00 00 60 ha, e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-73317036-00006, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00351-3 zona kadastrale Hani i Elezit.

Pika (j): parcela Nr.395-0, pronë shoqërore, zonë urbane, me kulturë livadh i kl.5 (pesë) në vendin e quajtur "Matana" në sipërfaqe prej 00 13 53 ha e evidentuar në qertifikatë pronësie nr.UL-7317036-00010, nr. i ri i qertifikatës P-73317036-00395-0 zona kadastrale Hani i Elezit.

Pikat tjera të vendimit Nr.3444/2023 mbeten në fuqi.

2. Po ashtu, me këtë vendim shfuqizohet pjesërisht vendimi i Kuvendit Komunal me nr.01/Nr.2457/2023 të dt.30.03.2023 mbi shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parceleve si më poshtë vijon:

- a. P-73317036-00348-2 z.k. Hani i Elezit, në sip.427m² me kulturë kullosë e kl.5,
- b. P-73317036-00348-2 z.k. Hani i Elezit, në sip.285m² me kulturë kullosë e kl.5, dhe:
- c. P-73317036-00348-2 z.k. Hani i Elezit, në sip.287m² me kulturë livadh i kl.5.

Parcelet e lartëshënuara me shkronjat a,b,c janë prona të P.Sh. Fabrika e Qimentos "Sharr" Hani i Elezit dhe me këto prona menaxhon Agjencioni Kosovar i Privatizimit "AKP".

Pjesët tjera të vendimit me nr.2457/2023 mbeten në fuqi.

3. Me këtë vendim mbi heqjen e barrës të interesit të ligjshëm publik mbi parcelet e lartëcekura sipas vendimeve të Kuvendit Komunal me nr.3444/2013 dhe nr.2457/2023 do të njoftohet Axlencioni Kosovar i Privatizimit, i cili menaxhon me këto paluajtshmeri.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i komunës, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Arkivit i Komunës.

Hani i Elezi
Data: 10.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr.2457/2023

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Ligji për Shpronësimin e Paluajtshme Nr.03/L-139 neni 4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2023 merr:

VENDIM

PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PRONAVE TË PALUAJTSHME

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave si në vijim:

Parcela me nr. P-73317036-00362-0 me sip. 1609m² Z.K Hani i Elezit, me kulturë livadh e kl.5.

Kjo parcelë është pronë e P.Sh. Industria Kimike-Organike "Kosovaplast" Zagreb. Prona aktualisht është në menagjim të AKP-s. Mbi këtë parcele dhe disa parcele tjera është e ndërtuar vitin 2000-2001 fusha e futbollit. E njëjta është rindërtuar vitin 2018 dhe 2019.

Parcelave si në vijim:

- + a. P-73317036-00348-2 z.k. Hani i Elezit, në sip. 427m² me kulturë kullosë e kl.5,
- + b. P-73317036-00349-8 z.k. Hani i Elezit, në sip. 285m² me kulturë kullosë e kl.5,
- + c. P-73317036-00351-2 z.k. Hani i Elezit, në sip. 287m² me kulturë livadh e kl.5.

Parcelat e lartëshënuara me shkronjat a,b,c janë prona të P.Sh. Fabrika e Qimentos "Sharr" Hani i Elezit dhe me këto prona menaxhon AKP.

Mbi këto parcele është e paraparë zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës dhe urës (mbikalimit) të hekurudhës në afërsi të stadiumit të futbollit dhe terminalit doganor.

Parcelave si në vijim:

- a. P-73317079-01241-0 z.k. Seqishtë, në sip. 3610m² me kulturë arë e kl.7,
- b. P-73317079-00042-0 z.k. Seqishtë, në sip. 2290m² me kulturë arë e kl.7,
- c. P-73317079-00043-0 z.k. Seqishtë, në sip. 528m² me kulturë mal i kl.5.

Parcelat e lartëshënuara me shkronjat a,b,c janë prona private të Emin Shaip Kalisit.

Në këto parcela me PZHK është e paraparë ndërtimi i shkollës fillore për nxënës të Lagjes së Re dhe pjesës nën hekurudhë.

Parcelat si në vijim:

- a. P-73317036-00204-0 z.k. Hani i Elezit, në sip.2065m², pjesa për shpronësim 40m² me kulturë arë e kl.4 me pronar privat Pajazit Imer Daci nga Hani i Elezit,
- b. P-73317036-00208-0 z.k. Hani i Elezit, në sip.1741m², pjesa për shpronësim 975m² me kulturë arë e kl.4 me pronar privat Habib Afet Bushi dhe Fadil Afet Bushi nga Hani i Elezit,
- c. P-73317036-00209-0 z.k. Hani i Elezit, në sip.1137m², pjesa për shpronësim 481m² me kulturë arë e kl.4 me pronar privat Aqif Ramadan Bushi,
- d. P-73317036-00210-0 z.k. Hani i Elezit, në sip.1287m², pjesa për shpronësim 616m² me kulturë kullësë e kl.3 me pronar privat Mendu Ramadan Bushi,
- e. P-73317036-00211-0 z.k. Hani i Elezit, në sip.718m², pjesa për shpronësim 414m² me kulturë kullësë e kl.3 me pronar privat Zejadin Sami Bushi.

Parcela e lartëshënuara me shkronja a,b,c,d,e dhe h në sip. totale prej 2773m² janë prona private dhe me plan është e paraparë ndërtimi i mbikalimit të hekurudhës prapa Qerdhës së qytetit dhe rrugës ekzistuese para urës së Fezës.

2. Duke ju referuar nenit 1 të këtij vendimi, ekzekutimin e mëtutjeshëm të shpronësimit do ta kryen ekzekutivi i komunës sipas procedurave ligjore .

3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal,
- Ministria e Financave dhe
- Arkivit i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30.03.2023





Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



